



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 43, datë 03.06.2022

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË "INFERMIERI MAMI", TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",
VLORE

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr.1, datë 07.04.2017, "Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, "Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit" dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 "Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit", në mbledhjen e tij të datës 03.06.2022, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Infermieri Mami", me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në "Infermieri Mami"
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/ licensimit: Shkresë e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 2234, datë 17.06.2002.
- d) Akti zyrtar i riorganizimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 398, datë 10.08.2011
- e) Institucioni që e ofron: Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
- f) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Kujdesit Shëndetësor
- g) Kohëzgjatja (Vite/ semestra): 3 vite / 6 semestra
- h) Kredite (ECTS): 180 kredite
- i) Forma e studimit: Me kohë të plotë

- j) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
- k) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuara e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *"Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor"* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është **"i përmbush pjesërisht standardet"**, me mangësitë si më poshtë:

1. Fusha e ekspertizës e disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, nuk është në përputhje me lëndët që ata mbulojnë.
2. Disa nga anëtarët e personelit akademik të këtij programi studimi, nuk zotërojnë kualifikimin e nevojshëm për tu angazhuar si lektor në këtë program studimi.
3. Titullarët e disa prej lëndëve/moduleve të përfshira në kurrikulën e këtij programi studimi, nuk janë të kategorisë profesor, sikurse parashikohet në aktet ligjore në fuqi.
4. Mungesa në përbërjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm.
5. Literatura e përfshirë në syllabuset e këtij programi studimi, nuk është të paktën e pesë viteve të fundit.
6. Realizimi pa sekretim ose kodifikim i provimeve, për studentët e këtij programi studimi.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,


VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Bachelor** në “**Infermieri Mami**”, të **Universitetit “Ismail Qemali”**, Vlorë, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **3 (tre)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **02/06/2025**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

ALEXANDER KOHLER




Anëtar

AYŞEN SAVAŞ SARGIN




Anëtar

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

IRAJ HASHI




Anëtar

MAURICE OUDEJANS



Anëtar

LEA YPI




Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ



Anëtar

DARINKA PIQANI



Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 43, datë 03.06.2022,
“Për akreditimin e parë të programit të studimit Bachelor në “Infermieri Mami”, të Universitetit
“Ismail Qemali”, Vlorë, janë si vijon:

1. Institucioni, të marrë masa që, fusha e ekspertizës e personelit akademik që angazhohet në këtë program studimi, të jetë në përputhje me lëndët që ata mbulojnë.
2. Institucioni, të marrë masa që i gjithë personeli akademik i angazhuar si lektor në këtë program studimi, të ketë kualifikimin e nevojshëm sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Institucioni, të përcaktojë si titullarë të lëndëve/moduleve, personel akademik të kategorisë profesor, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
4. Institucioni, të përfshijë në përbërjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfqësues nga studentët dhe ekspertë të jashtëm.
5. Institucioni, të marrë masa që, literatura e përfshirë në syllabuset e këtij programi studimi, të jetë e perditësuar dhe të paktën e pesë viteve të fundit.
6. Institucioni, të marrë masa që provimet e studentëve të këtij programi studimi, të zhvillohen me sekretim ose kodifikim.
7. Institucioni, të rishikojë rregulloren e departamentit përgjegjës për këtë programi studimi, rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset, me qëllim që informacioni në to për frekuentimin e leksioneve, seminareve si dhe për numrin e krediteve që studentët duhet të fitojnë për të kaluar në vitin pasardhës, të jetë i saktë dhe i unifikuar.
8. Institucioni, të krijojë një databazë e ta përditësojë atë vazhdimisht, me të dhëna mbi punësimin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi.
9. Institucioni, të rrisë përpjekjet për mbështetjen dhe dokumentimin e aktivitetit kërkimor-shkencor, të personelit akademik të këtij programi studimi.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

